

BIBLIOTEKA

BSH-1

A 85

ALI
ASLLANI



891.9834

11. 24. 1900
MILWAUKEE
WISCONSIN
U.S.A.

814-1

P.85



11421

POEZIA

SHQIPE

ALI

ASLLANI


SHTËPIA E BOTUES - NAIM FRASHËRI

Zgjedhur e redaktuar nga
RAZI BRAHIMI

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»



ALI ASLLANI



PARATHËNIE

Ali Asllani lindi më 1882. Mësimet fillore i kreu në Vlorë, të mesmet në Janinë dhe të lartat në Stamboll. Më 1912 ishte sekretar në qeverinë e Ismail Qemalit dhe pastaj kreu detyra të ndryshme në përfaqësitë shqiptare jasht vendit dhe në administratën shtetërore.

Shkroi shumë, po para çlirimit, duke iu nënshtruar koncepteve obskurantiste të qeveritarëve të asaj kohe, që e quanin krijimtarinë letrare të padenjë për nëpunësit e shtetit, botoi shumë pak në gazeta e revista. Vetëm më 1942 botoi poemën humoristike «Hanko Halla». Krijimtaria e tij në mënyrë pak a shumë të plotë u njoh gjatë viteve të fundit të jetës së tij me botimet «Vidi-vidi, pëllumbeshë...» (1960) «Shqipëria kryezonjë» (1962) dhe «Ku merr zjarr rrufeja» (1966). Vëllimi i fundit është një përmbledhje me krijimet e tij më të mira poetike. Pas çlirimit, ndonëse në moshë të thyer, ai shkroi në

fillim disa vjersha humoristike, kurse pas vitit 1960 botoi mjaft vjersha entuziaste për jetën e re që po ndërtohej në Shqipëri.

Ali Asllani është poet lirik dhe satirik. Poezia lirike e tij karakterizohet nga një frymë e ngrohtë dhe e natyrshme popullore dhe është e afërt me këngën popullore labe. Ai këndoi brengën e popullit të robëruar e të kanosur nga të huajt («Gjoni», «Dëshpërim dhe shpresë», etj.), himnizoi heroizmin popullor në luftën e Vlorës («Epopeja e Vlorës» «Vlora, Vlora»), po më shumë i u kushtua poezisë me temë shoqërore dhe të dashurisë, në të cilën ndihet konceptimi popullor baritor i jetës, i dashurisë dhe i botës, dëshira për ta gëzuar jetën, që kalon disa herë deri në një epikureizëm origjinal fshatarak. Në tematikën shoqërore ai u kufizua vetëm në kritikën kundër zakoneve dhe mentaliteteve të vjetra dhe pothuajse asnjëherë nuk arriti të prekë strukturën klasore të shoqërisë.

Si poet satirik, Ali Asllani, krahas kritikës kundër zakoneve dhe mentaliteteve të vjetra, që e zhvilloi edhe pas çlirimit, përdori edhe satirën politike, sidomos kundër pushtonjësve të huaj dhe veglave të tyre («Nastradini-Musolini», «Hakërrim», etj.). Në poezinë e tij satirike vend me rëndësi zë poema «Hanko Halla», që është edhe një nga veprat më të shquara të këtij lloji në letërsinë shqiptare. Në këtë poemë ai vë në lojë atë tip shoqëror, që mbahet e mburret

me të kaluarën dhe i kundërvihet qytetërimit, i ushqyer nga nostalgjia për të vjetrën patriarkale dhe nga dëshira për ta kthyer botën prapa. Hanko Halla është një tip letrar i plotë, në të cilin spikasin mirë tiparet e një bejlereshe, që nuk pajtohet kurrsesi me asnjë shenjë të përparimit, ndaj edhe bëhet qesharake.

Poezia e Ali Asllanit, shkruar pas çlirimit, nuk ka vlerën e krijimeve të tij më të mira të së kaluarës, po, sidoqoftë, ajo është një këngë plot entuziazëm dhe një dokument artistik me interes për të gjykuar si e shihte poeti plak jetën e re që po ndërtohej në vendin tonë.

Në tërësinë e vet, qoftë për theksin e veçantë ideoemocjonal, qoftë për trajtën poetike, poezia e Ali Asllanit ze një vend të veçantë në historinë e letërsisë sonë, ndonëse nuk arriti të jetë aq përfaqësonjëse sa krijimtaria e poetëve tanë më të shquar.

Ali Asllani vdiq më 1966 në moshën tetëdhjetë e katër vjeç dhe deri në ditët e fundit nuk pushoi së shkruari.

The first part of the document is a letter from the
Secretary of the State to the President, dated
January 1, 1877. The letter is addressed to the
President and is signed by the Secretary of the State.
The letter is a copy of a letter from the Secretary of the State
to the President, dated January 1, 1877.

The second part of the document is a letter from the
President to the Secretary of the State, dated
January 1, 1877. The letter is addressed to the
Secretary of the State and is signed by the President.
The letter is a copy of a letter from the President
to the Secretary of the State, dated January 1, 1877.

The third part of the document is a letter from the
Secretary of the State to the President, dated
January 1, 1877. The letter is addressed to the
President and is signed by the Secretary of the State.
The letter is a copy of a letter from the Secretary of the State
to the President, dated January 1, 1877.

The fourth part of the document is a letter from the
President to the Secretary of the State, dated
January 1, 1877. The letter is addressed to the
Secretary of the State and is signed by the President.
The letter is a copy of a letter from the President
to the Secretary of the State, dated January 1, 1877.

K Ë N G E

Ah ky vend, ky vend, ky vend,
zot me pushkë e zot me pendë,
zot me pendë e me parmendë!

Pushka, penda dhe parmenda,
këng' në stane, këng' në tenda
na i ka të gjith've ënda!

Na kërkohmë ditë e dritë,
duam që ylli yn' të ndritë,
Prometeja jemi vetë;

kryeënda jon' në jetë:
të vrapojmë për në qiell
dhe të mbarim dritë e diell!

G J O N I

Gjoni i gjorë po rënkon,
po rënkon e po rënkon,
nata një e ai një,
ka një dert e ka një gjë!

Na arriti, thotë bota,
thashetheme dhe të kota,
na arriti paravera,
iku dimri, heshti era.

Gjoni i gjorë e gjoni i mjerë,
puna jote kurdoherë:
qaj mbi dega, qaj mbi shkarpa
sa të vete buza prapa!

Pa at mbete a pa mëmë,
apo ndonjë tjetër gjëmë

të qëlloi e të goditi,
të dy sytë t'i pëlciti?

Kush të paska therur kaq?
Ç'të ka marr' në palcë paq?
Kush të ther e kush të gris,
cila shpresë t'u vithis?

A je babë dhe fëmija
po të vdesën nga uria?
A je nënë e të vjen keq —
djali i vetëm po të heq?

Apo shumë e madhja gjëmë, —
më e madhja gjëmë e nëmë, —
humbe vend e mbete rob,
mbete qyq e mbete korb?

A je nder e nëpërkëmbe?
A je bër' kafshat' në dhëmbë?
A je zemër nënë shqelme
plot me vrer e plot me helme?

A je plagë, a je lot,
apo je i kastriot
dhe s'të mbeti mik e shok
të jap' kokë e të marr' kokë?

Korbi ti që s'ke të dytë,
shumë i hidhur fati ytë!

Shumë i hidhur, shumë e shumë,
mir'po imi më për lumë.
Kam një dert që s'thohet sheshit,
un' kam dertin e arb'reshit!

Unë kam dertin, atë dert
për një fjal' të lir' të shkretë,
për një fjal', një fjal' të lirë
digjem plumb në zjarr i shkrirë!

Gati thika të më grisë.
robërin' s'e kam për fis!
Gati thika të më therë,
vendi i mjerë e kombi i mjerë!
Nga të vemi, ku të vemi,
një kafshat' e vogël jemi!

E nuk mundem të bërtas,
e nuk mundem të pëlcas;
s'mbeti shpresë që të ngjallem,
s'mbeti vend — o që të kallem.

Që të rroj, kujt t'i lutem?
Që të vdes, ku të futem?

E pra, hesht e vuaj, vuaj,
plaç, o Zot, që rri i huaj!

Nuk lëviz se ka tërkuzë,
nuk qëndroj se jam në buzë,
vështro poshtë e vështro lartë,
në të mëngjër, në të djathtë,

andej lum' e këtej detë,
dhe më tutje tatëpjetë,
burri i lidhur me litarë,
m'u bë copa pallë e larë,
dorëlidhur, gojëlidhur,
puna ime më e hidhur!

1918.

DËSHPËRIM DHE SHPRESË

Edhe sot e këtë orë,
edhe sot ajo stuhi,
ajo flamëmadhe dorë
do na bëjë tym e hi!

Komb i varfër, komb i gjerë
si një zog i pafolë,
një pëllumb i bardhë borë,
ngeli keq në një rrëke!

Që nga Korça gjer te Shkodra
fati i vendit errësirë,
nëpër fusha, nëpër kodra
fryn e shfryn një egërsirë.

Komb i varfër, komb i mjerë,
i pamëmë e i paatë,

shpresa jote këtë herë
si një flet' në deg' të thatë!

Komb i varfër, komb i mjerë,
derëzi e punëzi,
edhe sot si kurdoherë.
një njeri i panjeri!

* * *

Jo, se ja dhe hëna mbrëmë
dukej kredhur në një rrobë,
edhe nxinte si një nëmë
që ka mbetur qyqe-korbë!

Mir'po sonte bukuri,
buzë e saja burim gazi,
dhe nga gjiri i saj zbraz
vargje-vargje drit' flori!

Nuk e di se qysh dhe si,
nuk e di se qysh nga se,
po nashti një shpresë e re
shtin e shkrep në sy të mi.

Do na zhduket errësira,
do të zhduket ajo dorë,

nesër vjen me shum' të mira
shkaba jonë dykrenorë.

Nënë hijen e asaj
paravera është' përhera,
që nga fundi gjer në maj'
rreth e rrotull ylyvera.

Anëmbanë bukuri,
komb i lirë, tokë e lirë,
shqipëtar e Shqipëri
sa të lumtur, sa të mirë!

1918

VLORA, VLORA!

Rroka armët, sheshit dola,
milion dyzetve u fola:
a do hiqeni si miq,
a na prisni si armiq!

Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,
bjeri, moj, të lumtë dora!

Rroka armët e u turra...
këtu burri vlen shtat' burra!
Andej ishin mizë e lisit,
këtej ishte lulja e fisit!

Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,
bjeri, moj, të lumtë dora!

Jasht'! — i thashë, i thashë, i thashë,
nuk dëgjoi dhe unë i rashë.

Ai iku mori denë,
nami im po mori dhenë!

Ai kish dhe ish pajisur
që në fill e në gjëlpërë,
kurse unë — i plagosur —
gjakun s'kesh me se ta zërë!

Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,
bjeri, moj, të lumtë dora!

Jam vlonjat dhe kryelartë,
di të bëj luftë me të shtatë,
a me hir a me pahir
doemos do rroj i lirë!

Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,
bjeri, moj, të lumtë dora!

1920


PËR DËSEMORËT

Jepi dorën, jepi dorën
këtij djali që i ati
na dha gjithë atë që pati;
na dha jetën, na dha Vlorën!

Jepi dorën, jepi dorën
kësaj nëne që i biri
iu këput si yll nga gjiri,
qyqe, korbë e la të gjorën!

Jepi dorën edhe asaj,
asaj vajze që rënkon,
ku është baba... e kërkon!

Mos harro dhe pasandaj
dhe atë të zezë grua
që ka humbur një dragua!



11422

Si, pra, Vlora t'i harrojë,
nderë e fjalës ta mjerojë;
çfarë i thanë dhe çfar' u tha
majë malit Barçalla?..*)

*) Botohet e shkurtuar.

PRANVERA NË SHQIPËRI

Rreth e rrotull pyje bushi
me dorë hyu të qëndisur,
e kudo një pjergull rrushi
fsheh një zan' të arratisur!

Me një pikëz re në ball'
çelet dielli n'paraverë,
mbasi vjen një çast vërdall'
dallandyshja zbret mbi derë!

Tani dielli ka të ngjarë
me një çup' me kuk' në faqe
edhe puthjen më të parë
ja jep lules manushaqe!

Vendet tona përsëri
nisen e stolisen rëndë,

falet dielli drit'flori,
ndizet hëna dritergjendë!

Falet hëna dritergjendë,
ndizet dielli drit'flori,
nisen e stolisen rëndë
vendet tona përsëri!

Zbresin qiejt një me dy
bashk' me yjet që këputen,
si beberat nëpër sy,
nëpër uj'rat tona futen!

Në zbardhim të par' të qiellit
ia nis fyelli nëpër pyje,
në mbarim të rrezes diellit
zën' e shkasin mijra yje!..*)

*) Botohet me shkurtime.

OKUPATOREVE

Aty ndal!

Gjalmëzeza ka bër' djal',
djal' fajkua, djal' sqifter,
pra, në vetull gjak të merr;
djal' fajkua, djal' fatos,
aty ngul dhe aty sos!

Ti ku vete? Ku po vete?

Frënk, o frenk, që s'je në vete!
Këtu furka e një stani
ka dy presa jatagani;
nënë këmbë të një dhie
zhduket gjurmë e një hordhie!

Aty ndal, sepse këtu

si çdo gur e si çdo dru,
bëjnë gojë e bëjnë dhëmbë,
dufi i tyre djeg e shëmbë!

Druri, eshtra e një dreri,
të një pulsi, të një zëri,
përmbi dega shkrifet sqifi,
nënë dega shtrihet difi!

Guri, gur i një qivuri,
rrëfen varrin e një burri,
të një burri, burr' me besë,
që ka ditur si të vdesë!

Shtrydhe tokën, kullon gjak,
në një çap e dy bonjak',
s'hahet haka e këtij gjaku,
s'tretet loti i një bonjaku,

të bonjakut pa këmishë,
gjith' kokalla të pamishë,
më i lumturi si plis
kalipeç mbi një kurris.

Këta rripen, po do rriten,
për atdheun dinë e vriten,
dinë e vriten, dinë e vrasën,
dinë armikun ta përplasën.
Ti ku vete? Ku po vete?
Frënk, o frënk, që s'je në vete!

HAKËRRIM

Që nga Korça gjer te Shkodra mbretëron një errësirë,
nëpër fusha, nëpër kodra vërshëllen një egërsirë!
Pra, o burra, hani, pini, hani pini orë e ças,
për çakallin nata e errët është një ras e deli ras!

Hani, pini dhe rrëmbeni, mbushni xhepe, mbushni
arka,
të pabrek' ju gjeti dreka, milioner' ju gjeti darka!
Hani pini e rrëmbeni, mbushni arka, mbushni xhepe,
gjersa populli bujar t'ju përgjigjet: peqe, lepe!

Ai rron për zotrin' tuaj, punë e tija, djersë e ballit,
është' kafshit' për gojën tuaj. Rroftë goja e çakallit!
Shyqyr zotit, s'ka më mirë, lumturi dhe bukuri,
dhe kur vjen e ju qan hallin, varni buzë edhe turi.

Hani, pini dhe rrëmbeni, është koha e çakenjvet;
hani, pini e rrëmbeni, është botë e maskarenjvet!

Hani, pini, vidhni, mblihdni gjith' aksione, monopole,
ekselenca dhe shkëlqesa, *tutti quanti come vuclë!*

Nënëshkrimi i zotris' suaj nëpër banka vlen milion,
ju shkëlqen në kraharuar dekorata «Grand cordon»!
Dhe kërkoni me ballëhapur (!) kombi i varfër t'ju
thërres'

gjith' me emrin tingëllonjës: «ekselenca dhe
shkëlqes'»

dhe të quheni përhera luftëtarë e patriot';
në ka zot dhe do duroj', poshtë ky zot, ky palo zot!

«Grand cordon» i zotris' sate, që në gji të kanë
vendosur,

është' pështyma e gjakosur e atdheut të veremosur;
dhe kolltuku ku ke hipur, duke hequr nderin zvarr',
është' trikëmbshi që përdita varet kombi në litar!

Dhe zotrote kurulldisë, diç u bëre e pandeh,
kundër burrit të vërtetë zë e vjell e zë e leh!

E na tunde, na lëkunde, nëpër salla shkon e tunde,
mbasi dora e armikut ty me shok' të heq për hunde.
Rroftë miku yt i huaj, që përdita los e qesh,
të gradoi katër shkallë, pse i the dy fjal' në vesh!

Koha dridhet e përdridhet, do vij' dita që do zgjidhet,
dhe nga trasta pemë e kalbur doemos që jasht do
hidhet!

Koha dridhet e përdridhet, prej gradimit katër shkallë
nuk do mbetet gjë në dorë, veçse vulë e zez' në ballë!

Mir'po ju që s'keni patur as nevojë as gjë të keqe,
më përpara nga të gjithë ju i thatë armikut: Peqe!
Që të zinit një kolltuk, aq u ulët, u përkulët,
sa në prakun e armikut vajtët si kopil u ngulët!
As ju hahet, as ju pihet, vetëm titulli ju kihet,
tekta fshati i varfër digjet... kryekurva nis e krihet!

Sidomos ju dredharakë. ju me zemra aq të nxira;
ju dinakë, ju shushumja, ju gjahtar' në errësira!
Ç'na pa syri, ç'na pa syri!.. Hunda juaj ku nuk hyri:
te i miri, te i ligu, ti spiuni më i ndyri!..

Nëse kombi vete mbarë, nesër ju veproni ndryshe.
dylli bëhet si ta duash, kukuvajkë dhe dallëndyshe...
Kukuvajka gjithë me lajka, nesër silleni bujar,
nënë dorë e nënë maska, shkoni, jepni një kapar!

Dhe kujtoni tash e tutje me të tilla dallavere
kukuvajka do përtypë zog e zoga si përpara...
Jo, jo, grushti do të bjerë përmbi krye të zuzar've,
koha është e maskarenjve, po atdheu i shqipëtar've!..

Po një dit' që nis e vrëret do mbaroj' me bubullimë,
ky i sotni, zëri i errët, nesër bëhet vetëtimë
dhe i bie si rrufeja pasuris' dhe kësilloj,

nuk ju mbetet gjë në dorë, vetëm një kafshat' për
goj'!

A e dini që fitimi brenda katër vjet mizor'
nuk është yti, nuk është imi, është i kombit arbëror,
është i syrit në lot mekur, është i vendit djegur,
pjekur.

Ju do thoni si të doni... po e drejta dërmon hekur! *)

1942

*) Botohet me shkurtime.

PERLAT REXHEPI

Pyeta Labërinë:

— E ku është Perlati?

— Ish një suferinë
edhe shkoi e vajti.

Pyeta Shqipërinë:

— E ku është Perlati?

Kombi ulërinë
më shumë nga i ati.

Pyeta djalërinë:

— Ç'e bëtë shokun, mikun?

— Fat për Shqipërinë,
vdekje për armikun!

Tani ti dhe unë

gjithë e dim' Perlatin,
djep kishte Beunë,
varr ka Rozafatin...

BOTË E RE KJO, TUNGJATJETA!

Botë e re kjo, tungjatjeta,
edhe fusha u bë mal,
shkon përpjetë e tatëpjeta
mal e fusha u bënë pal'!

Fusha mal e mali — fush'
me një shkathje të çuditur,
këto vajza dy herë prush,
gjetën këngën e grabitur!

Llërdjegura në diell,
llërdjeguri në arë
po e bëjnë plisin miell
dhe ugarë ergjend e ar!

.....

SHKENCË E VJERSHË RANË GODI

Nisi shekulli titan
i atomit llahtari,
o njerinë e bën shejtan,
o shejtanë e bën njeri!

Dorë e shkencës bëri ç'bëri
dhe prej zjarrit kreu akull —
me një vrap më shumë' nga zëri
fluturon një palo kafkull!

S'paska lart e s'paska posht',
s'paska fund e s'paska krye.
rreth përqark të vetmit bosht
vijne vërdall' miliarda yje!..

.....

Orë e çast e një çudi,
orë e çast e më përtej,

shkencë e vjershë ran' godi,
van' ku ëndrra s'mund të vej'!

Se sa gjëra do shoh' syri,
se si është parajs' e feve,
si në gji hyria hyri
përmbi supin e rrufeve!

Brez për djepe dora e nënës
do ket' brez' e glyverit,
me ergjënd e ar të hënës
do tjer' fijet e qemerit.

Do shullëhemi në borë
sikurse në diell tashti,
me një or' që mban në dorë
flet me polet si komshi!

Kjo rrufe që sot na djek
do marr' formën e një kupe
dhë nga Marsi do gjej' shtek,
do sjell' letrat e një çupe!

Do sjell' fjalën e një femre
nga parajsat me hyri,
do sjell' këngën e një zemre
për njerinë e ri flori!..

.....

S'di, për Zotin, në do ketë
n'atë bot' bajram e pashkë,
po që hëna do të jetë
fushë e sportit e përbashkët!

Do na vijnë e do t'u vemi
tufa-tufa, vargje-vargje,
dhe kjo tokë që la Ademi
s'do jet' veçse një cop' lagje.

Dhe kjo tokë që la Ademi
një cop' lagje, lagje e diellit,
edhe neve do të jemi
nënështetasit e qiellit!

Dhe përhera sa më lartë,
pa pushim e pa këputje,
me një etje më të zjarrtë
që të gjith' do vemi tutje.

IMAN EFENDIU

Na, mor mik i dashur, kemi një iman.
sikurse një veshje rreth e rrotull dhjam',
rrethuar me shokë, me bij e me bija,
gjithë qyteti ynë është shtëpia e tija;
një baba për popull, një baba fëmije,
një uratë e madhe, njeri perëndije!

Kur që e thërresin këtu e aty,
efendiu yn' fjalën s'ta bën dy
në dasmë e në valle, nëpër zifafete,
lugën nënë mëngë, ai vjen e vete!
Plasi një dit' pushka, populli në sulm...
Eja, — i than' shokët — lufta është në kulm!
Mir'po efendiu qenka lodhur tepër;
Un, — thot' — kurdohera, s'paska njeri tjetër?

Eja, efendi, pasi kemi dasëm,
eja, efendi, hamë e pimë e flasëm,

eja, efendi, sonte kemi valle,
eja, efendi, se do qajmë halle!

Eja, efendi, kemi sihariq,
eja t'i ham' hallvën pasi vjehrra vdiq!
Erdhën dallëndyshet, tani vjen lejleku,
sosi revania, ja po vjen byreku,

eja m'u bëj kumtër, vajzën time qethe,
eja, efendi, e më ysht për ethe,
eja, efendi, eja, efendi...
tani u bë tepër dhe, për perëndi

më ka plasur buza, duke qenë i pari,
mir'po me një lule s'mund të vij' behari!
Tashti për në luftë radha është e juaj,
pasi qenka thënë, un' do rri të vuaj!

NASTRADINI — MUSSOLINI

Dikur Nastradini mbante në kafas
një siqok', të cilin ai e liroi
dhe i vajti pas...
Ga-ga-ga siqoka, shkoi e qëndroi
në bri të një kau...

«Hë, — thot' Nastradini, — lavdi pastë Allahu,
ngjau se si ngjau, u bë imi kau!
E zптоi siqoka, çupë e dashur ime,
me rrezik të jetës, sa shpëtoi në qime!
Tani këta ka s'e lëshoj nga dora
që me kaq mundime munda edhe e mora!»

Tani ju e dini,
dikur Mussolini
lëshoi ca siqoka nëpër dega lisi,
ku ia thon' shqiponjat këngës së një fisi.
«Tani, — tha — Ballkani — pronë e perandorit,

tejpërtej shqiptarët rrotull perandorit,
me një fat të ri, me një fe të re»
Me një fat të ri, nëse i vë re,
qenka mos na qenka, një përrallë e re!

Shqipëria është një vend i bukur
me një natë të mirë, me një diell të
nxehtë, me një det të qelqorë, me një
kulturë të vjetër dhe me një popull të
dashurorë.

Shqipëria është një vend i bukur
me një natë të mirë, me një diell të
nxehtë, me një det të qelqorë, me një
kulturë të vjetër dhe me një popull të
dashurorë.

QË KURSE U PRISH DYNJAJA

Qëkurse u prish dynjaja
i paudhi gjeti shtek,
pa bër dasma dhe duaja
futet dhëndrri në gjerdek!

T'i hajë ujku hoxhë e prift,
na jan' bërë mish e thua,
lan' rininë e bëhen çift
me një fjalë: më do, të dua,
dhe kapar një puthje hua!

Edhe femra, për së prapthi,
paska luajtur nga fiqiri
më par' fshihej gjer të lakthi,
sot të vret me bomba gjiri!

Gratë i thiri hyqymeti
që të shkruajnë në maqinë,

zotërinjtë, lumi-deti,
kruajnë magjet në kuzhinë!

S'mbeti mjekër e mustaqe
që t'i thot' gruas: sus!
dhe në hedhtë miell në faqe,
ta mbërthej' ta hedh' në pus.

KENGA E MUKËS DUHET TË HESHTË

Tani, tungjatjeta, Shqipëri e re!
Me llomi të zeza bëri palare,
palare të bardhë.
Ngriti radhë-radhë
një dynja të gjallë mbi një bot' gërmadhë;
një dynja me parqe,
një dynja çardhaqe,
dufi i tyre-punë, këngë e tyre-paqe!

Poplat e një shtufi,
ku mezi kolisen thonjët e një bufi,
na i bëri gota, gota farfuri,
t'i mbush' e t'i zbrazë brezi ynë i ri!

Na shartoi punën mu në palc' të diellit,
diellit të dembelit.
S'mbeti më nevojë për hallva të qiellit!

E, pra, kënga e Mukës duhet që të heshtë,
fjala më e thjeshtë,
para së vërtetës, eja e u fal,
qofsh dhe qyq më degë, nëna të ka djalë!

.....

.....

.....

DALLËNDYSHET DHE VAJZAT

Tash më dielli nuk të djek',
pikë e vesës lot pikon,
duket fleta që u prek,
duket flladi që rënkon!

Sapo vete dielli vrejtet
si një sy që u rrëmbush,
si një vashëz që po rrejtet
s'di se si dhe s'di nga kush!

Ta do zemra? I thuj: eja!
Një çift kite na mjaftojnë
dhe në vjesht', kur varet reja,
dallëndyshet udhëtojnë.

Dallëndyshet edhe vajzat
vijjnë e rrjedhin nga një derë,
në vjesht' shkojnë' këmbejn' unazat,
kthehen çift në paraverë!

PYETA VALET VOGËLUSHE

Pyeta valët vogëlushe
mu si rrathët e një gushe
përmbi supe nga një shkumë,
kush më pak e kush më shumë,
venë e vijnë e shkojnë e shkasin
dhe përhera për ty flasin.

Valëza, o valëza,
farë e fis me vashëza,
ku e keni shoqen tuaj?
Ruaje, zot, nga erë e huaj!

Pyeta zoga, pyeta zogj,
pyeta zemrën që m'u dogj,
pyeta lulet nëpër baça;
nëpër baça, që unë plaça,
muaj e vitra po të pres,
Vidi vidi të thërres!

Vidi vidi zogëzra,
farë e fis me zojëza,
ku e keni shoqen tuaj?
Një minutë e gjat' një muaj!

Vidi vidi pëllumbeshë!
Për ty qaj e për ty qesh,
për ty qesha; gjithë jeta
me gjith' lule, me gjith' fleta
u bë fli për ata sy,
çdo gëzim ta fala ty!

E çdo brengë e mbajta vetë.
Tash afroi e thënë e shkretë,
dhe unë s'di ku jam, ku vete,
rroj për ty e vdes për vete!

KATËR STINA, KATËR ÇAPA

1

Vjeshtë...
Nëpër hije s'ka më shije,
loti i parë dhe më i thjeshtë
është fletë e parë që bije!

Nëpër dega, nëpër gjethe
dorë e erës po trokit;
me rrënqethje si në ethe
fillon pema psherëtit!

Sosi kënga në fole,
hyri reja në kufirë,
dallëndyshja lere e le,
ia nis këngës: lamtumirë!

Dallëndyshja ime, haj!
do më lerë e do më shuaj,
ku do shkelë këmba e saj,
loti im do jetë i huaj!

2

Shkoi dhe vjeshta me sa pati...
vargje-vargje varet reja,
zbriti dreri i madh nga shtrati
po andej nga zbret rrufeja!

Bota mbytet nga një mjegull,
dita thyhet, nata rritet,
në oborr e shkreta pjergull
sa po vete po ronitet!

Qielli ulet, ulet, ulet
rreth e rrotull tym e ujë,
reja vjen, mbi supe ngulet,
erë e egër bën rrëmuje;

era vjen me duf si plumbi
dhe nuk lë fole në vend,
dallëndyshja ime humbi
edhe unë i humba mend'!

Kalon koha dalngadal'
 nata thyhet, dita rritet,
 dielli i dimrit rrallë për mall
 si sorkadh me çap vërtitet.

Mbi një degë a mbi një tjegull
 nunurit një zog i gjor',
 në oborr e shkreta pjergull
 merr një hov pranveror!

Ja dhe shkurti shkurtabiq
 s'le dy gurë në një qoshe,
 po vesh trupin lakuriq
 të bajames bukuroshe

Mars o mars me huqe shumë,
 një rremall e një nopran,
 aty vaj e aty shkumë,
 aty qesh e aty qan.

Është i gjer' sa është një botë
 dhe më vjen me ca rrëmbime,
 është i thellë sa është një lotë,
 po i hollë si zemra ime!

Paravera me bilbila
 koha qesh dhe buza qesh,
 diçka thon' për trëndafilin
 goj' për gojë e vesh për vesh!

Kridhet bota në stoli,
 në stoli e në sadefe,
 dridhet zëri në vjoli;
 dorë e vajzës rreh dy defe!

Ngrihet kupa me dolli,
 një dolli me tre shëndete,
 rrotull zoga meskali,
 dy për zogën, një për vete.

Pjesa ime tepër pak:
 pi dy kupa, hedh një sy,
 mezi marr një pikëz flakë
 sa për zemër... gjer aty!

5.

Erdhi vera përsëri
 kalipeç mbi shtiza dielli,

bejkë e stanit buzëflori
del e pret me këngë fyelli!

Përsëri dhe përsëri
përqafohen filladi, fleta,
ah, kjo kënga dashuri
është e ëmbël shumë e shkreta!

Ngrihet kupa me dolli,
me dollí e me shëndete,
un' po rri e vërshëlli...
as për zogën, as për vete!

Pjesa ime një puqer,
rrall' një vetull, rrall' një sy,
dhe si drita në uj' thyer
ca kujtime... gjer aty!

6

Shkoi dhe vera me aq bujë,
shkoi me gjithë ato stolira,
plaç, moj ver', çë për pak ujë
thave lulet më të mira!

E një vit i gjithë shkoi
katër stina, katër çapa,

un' kërkoj, kërkoj, kërkoj...
djalërinë që mbeti prapa.

Aty brenda kam ormisur
me kujtime, me gatime,
thellë e thellë i kam skalisur
në bërtham' të zembrës sime.

S'kalon koha, kaloj unë,
jetë, o jeta e flamosur,
jam në gusht dhe: gusht e gumë...
plaça un' që paskam sosuri!*)

*) Botohet me shkurtime.

ME LEJON TA PUTH NJË HERË

— Më lejon ta puth një her'
mu në cep ku është e thyer
atë vetull?

— Jo tashi,
shih si dridhet, do bjer' shi!
Kur qerpiku më lëvis,
njëmenjë dhe shiu nis!

— Po në mollëza, në faqe?

— Jo sot; nesër ose dej,
kur të vemi atje tej
për të mbledhur manushaqe.

— Po në sy?

— Përse, të lutem...

Pse kur ti më puth në sy
syt' më mbushen që të dy,
turbullohem e këputem...

— Po në buzë?

— Aty po,
buzën time do t'ta jap,
hënë e ngrënë bëhet prap'...
Bën si di e bën si do!

VAJZAT HEQIN VALLE

Vajzat heqin valle,
njera flet me vetull, tjetra me qepalle.
valle deli valle, valle për shtat' qejfe,
s'paska më mir' valle se këto me defe!

Si veriu verës kur takon me fleta,
fërfëllin tumanja, tumanet e shkreta,
si veriu verës mu në mes të vapës
xhanin ta shëron zëri i njomë i çupës.

Çapëzat e vajzës, çapëza pëllumbi,
të lehta si penda, të shpejta si plumbi,
edhe vajza vetë në krye të valles,
mu si pikë e lotit majave qepallës.

Lum kush i ka parë, kush i ka dëgjuar,
kur e heqin vallen me shami në duar,

me një dor' shamia, tjetra dor' në mes,
ulur të dy sytë, të dy sytë e zes.

Edhe flokët derdhur mbi supe të bardhë,
vajzat heqin valle një nga një me radhë,
e para, e dyta, e dyta e treta,
cilado, moj xhane, ka diçka të veta.

Lum kush i ka parë vajzat e arb'reshit,
mu si dallëndyshet rrafsh i ulen sheshit,
mu si dallëndyshet rrotull disa herë,
prap' si dallëndyshet kur i shoh në erë.

Dy ato të parat dridhen e përdridhen
hop mbi thonj të këmbës din' se si të hidhen,
dor' për dor' të gjitha shoqet rreth përçarkë
cilado një flutur gati për në flakë.

HANKO HALLA

— р о с ѣ —

100 100 100 100
100 100 100 100

100 100 100 100
100 100 100 100
100 100 100 100
100 100 100 100

100 100 100 100
100 100 100 100
100 100 100 100
100 100 100 100

100 100 100 100
100 100 100 100
100 100 100 100
100 100 100 100

HANKO HALLA

— 100 —

I

Halla ka marr' mashën, urat po i shkrep
edhe merr e jep, —
trungu i ullirit digjet me gazep,
digjet mala-mala, sidomos bujashka;
në dimër, moj motër, zjarri shumë u dashka!

Deh i lumtë goja kush e tha më par'
xhan e shpirt, o burrë, xhan e shpirt, o zjarr!
Buk' e that' në sofër, buk' dhe asgjë tjetër,
po agai sa malet edhe zjarr në vatër!

II

Rreth e rrotull zjarrit nunuris njeriu,
si gjithkush të tijat plaku dhe i riu...
Fjala e të rinjve çelet me përrallë,
me një gjum' të ëmbël gati mbi qepallë:

Ç'është njëz' e njëzë, ç'jan' ata dervishë,
ç'jan' ata dervishë, kryet me fildishë?
Ç'është ai që s'hahet, ç'është ai që s'pihet,
edhe nëpër xhepe kurrë e kurrë nuk vihët?

Fjala e të rinjve çelet me përrallë.
Brezi yn' po dihet, zëm' e qajmë hallë...
Një ka bër' të mira, po s'ka par' të mira,
tjetri qenka pjekur keq në takllaira; 1)

... plag've të atia nuk iu gjend melhemi,
dertet e këtia nuk i merr kalemi;
njëri s'paska miell, tjetri s'paska thes.
fund' i fjalës bota qenka e pabes'!

Muaj i shënëndreut, muaj i flamosur,
ngryset edhe s'gdhiet, nata s'ka të sosur.
Shumë i hidhur qenka, shumë e shumë pothuaj,
sa dhe pulat s'pjellin, brenda këtij muaj.
Enët mbahen mbyllur, qypa, shtëmba, butet,
pasi karakëshi (2) vjen e brenda futet!

Netët shumë të err'ta, dita shumë e vrazhd',
mbetëm mu si patat mbyllur në një grazhd;

1) Vuajtje të mëdha.

2) Turqisht: dimër i zi. Në popull: xhind.

pa le llafazankat vijnë e na bezdisin
nasi kot së koti zën' e kakarisin;
ruajna, Zot, nga fjala, zgjatet edhe zgjatet
sa me pash' njeriu s'ka se si të matet!

III

Xhiko Xhevahirja, Halla dhe Xhixhia
krushka Hanko Shega edhe xho Inxhia,
Bulla Qeribaja, dadara, gegera, (3)
zonjat e mëhallës që na vijn' ngahera,
veshur kadifera, veshur me shalira,
rroba rrob' Stambolli, s'paska më të mira!

S'paska më të mira, po, për sy të ballit,
bora më e pastër është' në maj' të malit,
rroba më e pastër është' mbi trup të Hallës,
mu si shkumë e bardhë mu në sup të valës!

Edhe rredhi i Hallës, rredhi i atij gjiri,
ruaj, Zot, nga syri, mu si prush floriri.
Duket derë e parë, bukuri e derës,
shquan mbi katër stina stina e paraverës!

3) Gege: gruaaja e dajës.

Ngulur mbi shiltera, gjithë ato shiltera,
hapur gjer te dera, shumë e shumë të vyera,
me ixhat Janine (4) lule ylyver,
dy mexhide topin Halla i ka bler'!

Pa dëgjoni, Zonja, — nisi Halla plak', —
do ju them një fjalëz, fjalë pa kapak!
Erdhi kohë e keqe, koha e flamosur,
na u prish dynjaja, bota është marrosur!

Sot një lajmës erdhi, e mir' se na erdhi,
pati çar nuk pati një nga një i derdhi;
lajkat më të rralla, lajkat më të holla...
mbret mbi pem' limoni, mbretësh' dhe molla...
Fjala vinte rrotull, rrotull e vërdallë,
ç'do t'i thot' limonit mollë e kuqe vallë?

Thuaj e thuaj e thuaj edhe shumë përralla,
herë i terej zëri, herë i terej fjala,
herë i terej fjala, herë i terej zëri,
dale me ngadale mos këputej përi,
herë i çelej buza, herë i çelej gazi.
dha e dha e mbushi... pasandaj e zbrazi:

4) Basmë.

Qenka mos na qenka, një hadi bilmes, (5).
na e do për nuse çupën time mbes'!
Fët e fët e mora një kongjill nga zjarri,
nxora dhe nga xhepi një gjerdan prej ari:
«Na — i thash', — trazoi», nuk trazohen kurrë,
njëri për në gushë, tjetri për në furrë».
U! më mart' të keqen, dhe m'u bëft' kurban
farefis i tija anemban' ku jan'!

IV

Halla thot' të drejtën, çupa si dy sytë
si do bëhej nuse, nuse e derës s'dytë,
kurse Hanko Halla rrjedh nga derë e parë?
Bota të mos kishte disa pashallarë,
soj i Hanko Hallës do të kish me hak
që të kish saraje dhe të ish oxhak;
Halla do të quhej Halla pashallesh',
fjalë e saj do ishte mu si vëth në vesh;
Halla do të bënte si ta kish istekun, (6)
eja — ik mileti, merr e puth etekun! (7)

5) Turqisht: njeri që nuk di hatin, domethënë kapërcen
kufitë e vlerës së vetes.

6) Turqisht: dëshira

7) Turqisht: pëqi

Gjyshi paska pasur shum' para të thata,
paska pasur arqet plot me kollonata, (8)
paska pasur mbushur arqe e sënduqe
me para të bardha, me lira të kuqe;
gjalpë e vaji i tyre derdhej si përrua,
katër teste qypa kishin në katua,
katër teste qypa, katër teste zgjoje
mbushur me pekmeze, mbushur mjaltë e hoje!

V

Pastaj — vazhdon Halla — patëm disa halle,
malet u bën' fusha, fushat u bën' male;
fushat u bën' male, malet u bën' fusha,
humbi dhe floriri varur nëpër gusha!
Dale me ngadale humbën gjith' stolirat,
humbën gjith' të mirët, humbën gjith' të mirat:
humbi dhe xhanfesi, humbi dhe atlasi,
prej të katër anëve damëllhana (9) plasi!
Humbi armë e burrit, humbi pallë e lar',
humbi rrobë e gruas kredhur gjith' në ar!
S'mbeti ar në xhepe, ari shkoi e shkriu,
s'mbeti gjak në zemra, gjaku i burrit ngriu!

8) Para turke para se të dilte mexhitja.

9) Pëlhurë, basme e keqe.

Ku është brezi i vjetër, brez që s'bëri mes
dhe që di e shuan dhe që di e ndes?
Flokuri i zi i tyre si lele asllani,
ball' i gjerë i tyre digjej yll karvani;
fjalë e fortë e tyre një e njësh me vulë,
shtati i hollë i tyre hedhur sa një kulë!

Ku është Labëria, Labëria e parë,
vëndi i jataganit, vëndi i pallës s'larë?
Ku është zonjë e vendit, dorë e llër' çelnik,
qafë e çap sorkadhe hedhur me deftik?
Qafë e çap sorkadhe, me deftik vërvitur,
dhe me thelp lajthie rritur e gostitur?

Ku janë ato femra, femra deli femra?
Ku janë ata meshkuj me një teste zemra?
njëri musi lisi, tjetri musi shkëmbi,
më së fundi mortja erdhi e i shëmbi!

Ku është Fejzo Xhafua, dif i vendit tonë?
Rrapua i Hekalit, burrë i ler' me hënë?
Çelua i Picarit, Çelua i Athinës,
krismat e rrufeve, gjëmë e suferinës?

E ku është Gjoleka, kryetrim i Kuçës?
E ku janë këmishat përmbi gju hajduçës?
E ku është xhyzdani, folla e pallaska?
Pa këto arb'reshi fare hije s'paska!

Tepër dredharake qenka kjo jallane,
e ku janë ajanët, (10) burrat hane-hane,
pleqësi e vendit veshur me fustane?
Veshur me fustane, hej... fustane e shkretë...
humbën parësia, humbe dhe ti vetë,
lisit të gremisur më s'i mbeti fletë!

VI

S'mbeti bor' në male, bora paska shkrirë;
s'mbeti uj' në fusha, ujët paska ngrirë!
Fusha paska dimër, mali paska vapë,
sqifi dhe sorkadhi humbi krah e çapë!

Mu në mes na theu dynjallëku i shkretë,
nuk na mbetën lule, nuk na mbetën fletë;
fletët na kan' rar', pëndët na kan' rar'.
nuk na peshon bota fare në kandar!

S'mbeti derë e hapur, humbi salltaneti,
humbën zifafetet, humbi muhabeti.
Plasën duke thirrur rroftë e qoft' mileti,
që të rroj' mileti, u bë kijameti;

10) Arabisht: senator.

ja, edhe mileti nashti u bë popull,
dhe nga sherr i tija mendja na vjen rrotull!

Populli si deshi bëri një kanun
që t'i thotë agait bujku: «si ti, un'!»
Si ti, un', moj motër, dhe s'ta ka për pes'.
breh Valiu i Korçës, fare dinglemes, (11)
i zoti i hostenit vjen e të merr pjes'
i zoti i fermanit mbet me duar në mes!

Musi lesh arapi bota u trazua;
duaxhiu i djeshëm sot na u harbua,
jo vetëm ha bukën edhe përmbys kupën,
po guxon e dashka dhe për grua çupën!

VII

Mbylle, më thon' djemt', tepër plak njeriu
bëhet mendjevogël mu si çilimiu.

Qenka si çdo plak
ena pa kapak!

Mir'po un' s'jam plakë, memur i harbuar.
shtatdhjetë e dy vjeçe vajti më ka shkruar.

11) Turqisht: që nuk dëgjon.

Unë e mbaj mend mirë, isha goxha keçe.
kur u bëra nuse isha njëzet vjeçe;
rrojta e martuar dyzet e dy vjet
dhe tridhjet ka burri që ndërroi jetë;
bëni mir' hesapin, dale me ngadalë,
ky harbut memur rrenacak do dalë!

Më par' kishim hoxhën me divit në bres,
shkruanin mbarë e bukur, shkruanin me kujdes,
jo vetëm deftera po edhe duara,
doktor e receta s'kish në koh' të para!

Me këto receta, me këto gënjeshtër
u helmua gjaku, u helmua eshtra;
zjarr në zemër s'mbeti, vajti e u shua,
dale me ngadale burri u bë grua!

E ku qenka parë, e ku është dëgjuar
që të hapë femra gji e kraharuar
dhe të shkoj' përpara, burri t'i vej' prapa,
ky pa hedhur çapin, femra hedh tri çapa?

Nuk i merr kalemi gjith' këto hesape,
kur që dorë e burrit futet në çorape
llërë e gruas doli lakuriq në shesh...
Gjen shejtani shesh edhe bën përshesh!

VIII

Mir' për na të parët s'mbeti fjalë e vend,
brezi i ri vall' ç'pati që u prish nga mendt'?
Gjeti çar nuk gjeti, pati çar nuk pati
amanet nga nëna, amanet nga ati
gjithë ato zakone, gjithë ato zanate,
gjithë ato që ishin burime, irate,
si ato të burrit dhe ato të femrës
thellë e thell' rrënjosur mu në thelp të zemrës
dhe për vendin ishin eshkë edhe stërrall,
që në gji të burrit zjarrë e mbajnë gjall'.
zjarrin e arb'reshit, zjarrin që ka pasur.

me atë që botës buzën i ka plasur;
zjarrin e arb'reshit, zjarrin e vatanit,
zjarrin që bën vendin vend të jataganit!
sidomos, moj motra, punën e tezgjahut,
që punonin zonjat me fuqin' e krahut,
me djersën e ballit,
pun'ra që tregonin shpirtin e të gjallit:
guna e mëngore, linja e jelekë,
leshin na i çonte stan i deles bejkë;
gjithë ato që ishin prokopi e tija,
dhe përhera mbahej shtëpi e fëmija,
gjithë ato që thoshin: «jemi gjithë arb'resh»
keq a mir' të ishin dhe kudo të jesh

një nga një i hodhëm mu si gun' të grisur,
deh, moj kokë e krisur, puna e mavrisur! (12)

Një nga një i hodhëm mu si gun' të vjetër
dhe nuk qem' të zotët që të bënim tjetër,
papo mbetëm drangull... në shi e në djell,
mbytur nëpër halle thellë edhe më thell»,

mbytur nëpër halle si një frënk myflis
me një pallto kashte hedhur mbi kurris,
dhe një palo shapkë me një pal' shallvare
dhe më keq akoma, që nuk vete fare,
veshur benevrecke ose një poture
dhe në rrip të mesit varur një kobure!
Jem bër', moj motra, çfar' të them nuk di.
gjysmë e trupit zok, gjysmë e trupit mi!

IX

Ku janë ato koh'ra, koh'ra të ergjendit,
kur na sillej qielli si baba i vendit!
Po ashtu dhe shiu, po ashtu dhe dielli
kurse na i deshnim binin që nga qielli;
me të hapur gojën qielli na i çonte,
mu në mes të vapës shi flori pikonte!

12) Greqisht: e zezë.

Ku janë ato koh'ra, koh'ra të ergjendit
Pra dhe beja bënej po për atë hënë,
Pra dhe benej po për atë hënë,
po për atë nënë.

për diell e për qiell,
dhe për atë Zot q'është' më i thell'!

Nashti kur betohet burri thot': «për nder»
be e par' dhe feja mbeti pa një vler':
bota u shkallmua, puna u trazua,
burri u bë grua, femra u harbua.
hoxha u bë prift, prifti u tërbua.
dhe, gjynah mos qoftë, bëhen mish e thua!
vera u bë dimër, dimri u bë bishë,
shiu na i kalbi mish edhe këmishë!

Gjëja më e vyer' mbeti pa një vler',
e pra hundë e botës duhej pakëz thyer...

Edhe mirë u thye,
pa kapell' në krye
mu si njeri pylli,
humbur vulë e ylli,
del e shëtiti burri...

Vdiqëm duke qeshur turku dhe kauri!
Qdo gjë e ka humbur, humbi dhe pusullën,
s'ka në dorë as kokën që të vër' kësulën!

X

Korr atë që mbolle, thënka fjalë e vjetër,
ja, nga anë e Zotit edhe v'rejtje tjetër:
vinte Ramazani, dimër qoftë o verë,
kthehej nga Qabeja hëna, menjëherë!
Nashti edhe hëna zuri shikon vrëngër!
pasi kemi ndjekur udhën më të shtrembër!

Pa vështroni hoxhët që aty më parë
shkruanin si desh' Zoti, me kalem të mbarë,
vinin nga e djathta, venin më të mëngjër,
nashti, t'i hajë ujku, zunë e shkruajn' shtrembër!

Gjith' këto gjynahe nuk i lan as deti,
duket që afroi koha kiameti.
Thënka dhe qitabi: rob' i kësaj jete
dale me ngadale nuk do jet' në vete,
sa që do harrojë portën e gjitonit,
sa që do pështetet degës së rigonit!

XI

Halla aty heshti, hoqi thell' në zemër,
diçka iu kujtua, sikurse një ëndërr...
Një kujtim i vjetër erdhi e qëlloi,
si një yll i djegur flakë e fill kaloi!

«Ai» i kujtohet, veshur me fustane,
në një dor' tespïhet vark e radh' merxhane,
dhe në dorën tjetër një çibuk sermaje
rrahur me sadefe, gurë qehribaje!
Vula dhe sahati varur për mbi gryk'
dhe mbi supe hedhur atë goxha qyrk.
Dredhur dhe mustaqet, dredhur e përdredhur,
brenda në silahe dy pisqolla kredhur,
kredhur dy pisqolla dhe harbinë e artë,
shpatullat një pash, koka atje lartë,
varet nga haremet, zbret në zapanara, 13)
zapanat' e shkreta, zapanat' e para!

Kur ja hipte kalit, kalit qyhelan (14)
edhe shkon revan
edhe qahjaj pas
me një dor' në vithe.. zemra fryhej gas!
Kali si drangua,
katër vetëtima shkrepse një potkua!

Ah! — thot' Hanko Halla, — kur ish «Ai» gjallë
kurr' nuk bënte «gëk» njeri në mëhallë! —
«Ai» na thot' Halla, — pasi femra kurrë
s'mund t'i flas' në emër burrit që ka burrë!

13) Dhomë pritjeje burrash;

14) Kalë i racës arabe.

XII

Tym e re e mjegull, dhe në mes të saj
shquan një drit' kandili terur e pa vaj...
shquan një dritë e varfër, shquan një dritë e
shkret,

s'ka fuqi të dëgjjet, ka fuqi të vret,
si një sy i bukur, flak e lot shteruar,
gati për t'u mbyllur gati për t'u shuar!

Ç'do kujtim i ëmbël po kështu na duket,
kurse ditë e jetës ngryset edhe muket;
kurse ditë e jetës iku e u ngrys,
duket sikur bota vajti u përmbys!

E... çfar' është kjo jetë! Nuk e di kush thënka,
qenka mos na qenka, një kujtim na qenka:
Vdiqe — të qan tjetri, linde — do qash vetë,
midis të dy lotëve një kujtim i shkretë!

2

Hallës nuk i hahet, Hallës nuk i pihet,
me të renë e saja fare s'po i kihet.
Nusen nuk e dashka sa në od' s'e qaska
dhe që kur se erdhi hal' në sy e paska!

Dhe që kur se erdhi Halla paska thënë:
Nuk më duket nusja nuse për të qënë.
Lum' shtëpi e babës diti dhe e nxori,
mjër' shtëpi e burrit, ra në lak e mori!

Tani — vazhdon Halla — si do ja bëj hallit?
Çar t'i bëj zemanit, pa për sy të ballit
do i thoshja djalit jepi pek e hak
edhe ktheje prapa, bosh me tre tallak! (15)
Shko andej nga erdhe, erdhe kot së koti,
se paraja kallpe vete te i zoti!

Çar t'i bësh zemanit, shumë zeman i keq,
shumë i rënd' për plaka, shumë i rënd' për pleq.
Hoxha nuk trazohet, kadi nuk na mbeti,
me të tilla femra hall i madh na gjeti!
Hall i madh me nuse, hall i madh me çupa,
një lëkur kunadhe hedhur përmbi supa
tunden dhe lëkunden dhe në mes këputen,
nëpër duar të shkasën, po në zemra futen!
Punë e tyre vetëm lahen edhe lyhen,
edhe nëpër valle venë e vijnë e thyhen;
femra me një mashkull, vallja vetë i dytë,

15) Arabisht: divorc.

plasur dell, i ballit, më u plaçin sytë!
Gjith' me flok' të prera,
jo alla garzone, jo alla bebera,
me një llër' të freskët nëpër diell të thekur,
me një trup të zeshkët nëpër kum të pjekur,
gji e gusha hapur digjen ylyver
me një mes të hollë gati për t'u thyer,
me një buz' të kuqe shumë e shumë të nxehur
dhe me atë vetull tejprtej të mprehur,
me ato vështrime mu sikur të lutet
gjan se hallemadhes shpirti i këputet;
me ato kapele varur gjer në vesh,
zjarri i xhehenemit doli krejt në shesh!

Jo, moj khane, kurrë s'mundem që ta heq
që të thon' se nusja ka një huq të keq;
na flë e na ngrihet kur asaj i teket
dhe i bën qepallat sikur qan e meket!
brenda s'e mban vendi, gjan se u shkallos,
jasht' na shkon përpara si një korcollos;
me ditë e me orë zgjatet e mbufatet
me hije të saja afër darkës matet!

II

Nuse e kësaj kohe tjetër zanat s'paska,
a do marr' kalemin që të bëj' laraska,

a do zër' të shkruaj ose do dëgjojë
një kuti të vogël që na flet me gojë.
Një kuti të vogël që mos qoft' të jet',
është' një frënk i marrë, çirret e bërtet!
Me një biz' në dorë bën sikur punon,
këmbën përmbi këmbë nusja e dëgjon;
me çudi, moj motër, si e qysh duron!
Duket nganjëherë zëri e lëndon,
Frëngu rri i qetë ose do bërtas,
nusja e humbet dhe i vete pas,
frëngu e ngrë zërin edhe sokëllin
nusja e lë përin edhe vërshëllin;
ai flet me vete, flet e flet përçartë
nusja s'është' në vete, bëhet më e zjarhtë!

III

Halla do një nuse, nuse goja plotë,
si një zall të bardhë, si një zall të fortë,
me shami në krye anemban' qëndisur
dhe me flok' të gjata prapa arratisur',
dhe me flok' të gjata deri mu në mes
mu si nat' janari sa të thell' të zes;
me shami të hollë ballë e faqe hedhur
sa t'i duket syri në qepalle kredhur;

me flori në gushë hapur mu si prush,
si t'ju them, moj motra... pjergulla me rrush!

Rrallë e tek të duket, rrallë e tek të flas',
një thëllëzë e bukur mbyllur në kafas,
mbyllur në kafas një thëllëz e bukur,
mu në mes të reve hëna në të dukur,
mu në mes të reve si hënë e si yll
ose si një xhinde fshehur në një pyll!

Halla do një nuse si edhe i biri
rrënjët prej ergjëndi, degat prej floriri,
me të folur Halla, nusja të hap' sytë
«Lepe» fjalë e parë, «peqe» fjalë e dytë;
edhe asgjë tjetër, vetëm «lepe», «peqe»,
pasi zemr' e Hallës qenka si një qelqe:
po u thye, vajti, s'ka më, ngjite, qepe,
zogu i plagosur di të kap' me sqepe!

IV

Çupa — tregon Halla — nuk stoliset fare
që ta njohën bota zogëzën beqare;
po kur bëhet nuse, nusja do të niset
me fleta me lule pema do stoliset!
Dora me këna, koka me mazi,
dhe në cep të syrit një gjëkafsh të zi,

«sevap» (16) e «xhaiz» (17) është disa pika erë
sa t'i njom' cullufet freskë e bukur prerë!

Hajde dhe shaminë, sado është gjynah,
lëre që ta lidhë shtrembër në një krah!
Po të sillet bukur si dhe gratë e para,
sidomos — thot Halla — dua temenara!

Temena e shkretë humbi si një ëndërr,
vjen të merr nga sheshi dhe të vë në zemër,
pasandaj në buzë, pasandaj në kokë
aty ku është vendi për miq e për shokë!
Aty ku ish vendi për miq e për shoqe,
kurse nashti femra, kokërr në karroqe,
vjen ta bën me kokë, pasi tash pothuaj
na u bën' frëngesha brenda disa muaj!

«Menjëherë u bëmë,

Zoti ia bëft' frëngut shapkën sa një lëmë»
thanë edhe u derdhën, rrafsha mos u vrafsha,
merr e bjer' përdita rroba të mëndafsha,
rroba të mëndafsha, rroba kashtë e bar,
nusja për një manto jep dy grushte ar!

Gjith' pazarin nusja mu në odë, e futi,

16) Arabisht: e pëlqyer nga zoti.

17) Arabisht: e lejuar nga zoti.

na u bë shtëpia magazi çifuti;
rroba për pasdreke, rroba për mëngjes,
rroba për në mjegull, rroba për në ves',
disa për në banjë, disa për në kum,
disa kur t'ia bëjë një daulle bum;
disa për në çajra, disa për në valle,
ruajna, zot, dhe rroba për në karnavale!
Disa për në dimër, disa për në verë,
tamam sa për vjehrrën që të fryhet vrerë!

V

Mir' se mëndjeshkurtër femra u harbua,
burri q'është burrë ç'ka që bëhet grua?
Çdo gjë ka të ngjarë, po kurrë edhe kurrë
dorën e një femre nuk e puth një burrë!

Pa më thoni, zonja, si ka sy e faqe,
si mundet e bëhet mashkull pa mustaqe?
Kurse be e burrit, beja më me hije
dora në mustaqe bëhej deri dije,
dora në mustaqe edhe mos u tund
pasi fjalë e burrit aty merrte fund!

Çdo gjë u ndryshua, çdo gjë u shkallmua,
koka u zbulua, këmba u mbulua,
kur në koh'rat tona, me të hyr' që hyje,

kundra mbetëj jashtë, festja përmbi krye;
nashti futet brenda çdo këpucë e lyerë
dhe kapele e pastër varet përmbi derë!

3

Halla paska pritur me them e të thash',
sa u rrit shelegu edhe u bë dash;
nusja, ajo nuse, ndiz' e fal cingar,
më shumë nga cingari nusja merrte zjarr!

Nusja, ajo nuse... ari i shtëpis'
bëri këmbë e iku, xhepi u vithis;
ari i shtëpis' bëri këmbë e iku
kur një nat' pas darke, një kokosh: kikiku!

Ish kokoshi i Hallës, një kokosh i bardhë,
një kokosh që shok've nuk iu linte radhë,
kur ia thosh i shkreti hipur përmbi shkallë,
zëri i tij, moj motër, ruante shtat' mëhallë!

Atë nat' — thot' Halla — bëri zë pa kohë,
na u prish dhe moti, bëri shi e llohë,
koha u ndryshua, moda u ndryshua,
«Dua dy pal'rroba» nusja u harbua,

njërën e do klosh, (18) tjetrën ohohosh,
zuri borxhë e parë dy mijë e ca grosh!

II

Një dit' më thosh' nusja, gjëra për të qeshur,
sa më ra prej krahut dhe këmishë e veshur:
«Hall', në ke të holla mbetur e kursyer.
lëri në një bankë, vendi më i vyer!»

Nuk e dinte nusja fjalën e të parit:
— haje, o i mënçur, mallin e të marrit. —
Ari, bija ime, ari i kursyer
vendin e ka bukur brenda në qemer!

Me të thirrur: xhepi!

xhepi të thot': lep!

Ari në qemer, foshnja përmbi bel,
na i tha i pari që shikonte thell'!

Ka edhe të tjera, fjalë q'i merr era,
mir' po nganjëherë nuk i nxë as dera.

Ç'pret nga brez' i ri?

Gjëja më çudi s'quhet më çudi!

18) Formë rrobash për gra.

Nusja paska parë në qitap të ri
që përpara ligjit jemi një llcji,
edhe un', moj motër, zëre nga ta zësh
me këdo një grua qenkam një e njësh!

Mirë i thash', moj bijë, po qitapi i vjetër
thenka një gjë tjetër:

Syri do t'i plasë, dora do t'i thyhet,
dora e mameshës që s'ju preu kryet
dhe ju la bela,
zjarr në xhep për burra, hal' në sy për gra!
Nashti jam mësuar
mu si majë e malit me dëbor ngarkuar!

III

Halla thot' të drejtën, nusja kur të flasë
para Hanko Hallës, fjalët mir' t'i masë;
nusja eci mëngjër ose shikoi vrëngër,
s'ka të bëj', se Halla ka një deli zemër.
Femra në ka një, Halla na ka dy,
dhe sado që fajin bam ta thot' në sy,
sa her' na ka falur! Nusja na lajthitet,
kokë e falur s'pritet!

Të rinjtë e të rejat jan' si ditë prilli,
 rriten dita ditës dhe si trëndafili
 herë i deh bilbili, herë i deh veriu,
 her' po kot së koti dehen vetvetiu,
 i riu veriu thënka dhe i pari,
 fjala e të parit vlen më shumë se ari!

Nusja paska prishur, lëre që të prishë,
 nuse e Hanko Hallës lindi me këmishë,
 pasi derë e Hallës është burim kismetit,
 dhe kismetit saja vjen si valë detit...
 nëse mbaron njëra, rrjedh e vjen një tjetër.
 dera është e hapur në shtëpi të vjetër!

Si e re që është edhe nuse e Hallës
 derdhet mu si vala, vala i ngjan valës;
 po sado të derdhet mu si valë e detit,
 nonjë dëm s'i bëhet detit e kismetit!

Shkoni e shikoni valën që valon,
 se sa shumë gjëmon, se sa pak gjykon;
 me re e me erë zë e guduliset
 tundet e lëkundet dhe nga shtrati niset;
 fryhet edhe fryhet duke ngritur kryet,
 pasandaj i tekët anës detit thyhet;
 njëra shkon përpara, tjetra turret pas,
 njëra do përplaset, tjetra do përplas';

si e si të bëjnë sa shumë e më shumë
mbi kurris të detit buj' e zhurm'e shkumë!

Mir'po deti det
dhe asgjë s'humbet!

Dhe sado që duket se u bë rrëmujë,
deti si përhera rrafsh e plot me ujë!

4

Shpirt e xhanë,
eja, më thot' nipi, vemi në Tiranë,
eja, Hall', të lutem, se do bësh sehir
zonja shumë të mira, burra shumë të mir'!

Lem, të kegen Halla, ti më rruash, të paça,
un' për her' të fundit do të dal, në dalça:
e do dal, do iki dhe do shkoj për jetë
në sehir' të fundit, në sehir' të shkretë!

Un', mor djalë i Hallës, nëna e shtëpis',
kam një tuf' me halle varur mbi kurris;
kam një tuf' me derte, kam një tuf' me halle
nga ato që zbardhin vetull e qepalle;
e i thashë i thashë... Djali, me shumë mall,
eja, nguli këmbët, xhan' e shpirt, o Hall'!

Desha dhe nuk desha,
hodha namazbezin (19), mirë e mirë u vesha,
dhe që atë ditë hipëm në kaike,
ish për her' të parë që po veja mike,
mike në pampor;
prita edhe prita, po sa prita s'di,
mbase nonjë orë,
si i thon' nashti, .

pasi dhe sahatin, sahatin e gjorë,
që kur na e prishën edhe e bën' orë,
— na u bë dhe koha fare li e lesh, —
sahatin e saktë nuk po e marr' vesh!

Prita në pampor, prita kot së koti:
as e zonja erdhi as edhe i zoti;
«miserdhe, moj zonjë» njeri nuk më tha,
frëngun dhe frëngeshën ujku që s'i ha!

Un', thot Hanko Halla, sado që kam rar'
matem e peshohem me flori e ar;
na jemi si rrëza, mu si rrëzë e diellit
që sado që bie lart nga majë e qiellit,
bie nëpër male, krahu nuk i thyhet,
bie në moçale, këmba nuk i lyhet!

19) Mbulesë e bardhë që e hidhnin gratë mbi krye.

II

Pasandaj pampori fryti e u nis;
si kërcasin muret, muret e shtëpis',
si kërcasin muret kur i rreh tërmeti,
po ashtu kërcasin kur i rrihte deti
eshtrat e pamporit; mir'po më së fundi
diti si e tundi!

Kur i vinte vala, bënte sikur kridhej,
kurse valës tjetër drejt për drejt i hidhej,
aty valës dukej anës do ja mbante,
kurse valën tjetër mes për mes e çante!

Ballë i bëri bukur detit të tërbuar,
një dybek i rrihte mu në krahuar,
dank e dunk dybeku... un' sa jesh' kumbisur,
kur dëgjoj ca pula tue kakarisur!

Tepër u habita, qenkemi në Vlorë,
apo harroj udhën ky i shkret pampor
dhe u kthye prapa? Po në mbeçim udhës?
Kur dëgjoj që thoshin: «Kena mrrri në Durrës!»

Që thoni, moj zonja, erdhëm në Tiranë.
Po kur disa femra, m'u bëfshin kurban,

disa qyqe femra më një qoshe mbledhur,
ferexhet e zeza përmbi krye hedhur,
koka e mbuluar, këmba e zbuluar,
ruajna, zot, nga femra kurse ka shkalluar!

Thon' se nganjëherë këto ferexhera
diku i ngrë era,
brenda duket zoga ballë e gushë flori
që i thot' Tirana «zogëza kumri»;
qenka guguftuja që i themi na,
mir'po është' gjynah, s'mundet «me u pa»!

Afër disa meshkuj, veshur, po si veshur?
disa për të qarë, disa për të qeshur;
në krye në këmbë pa shije pa hije,
qfar' t'ju them, moj motra, pika që s'iu bije!

Disa për të qeshur, disa për të qarë,
s'paska më shqiptarka, s'paska më shqiptarë!
Ku janë ato rroba, rrobat e të parit;
rrobat që peshohen me dërhem të arit?



Tej një shesh i gjerë bota jep e merr,
edhe një gjëlpërë s'ka se ku të bjer';
zonja e zonjushe si thëllëza fushe,

mu si pika ari, mu si flori gushe,
dy nga dy po ecin, me bërryle shtyhen,
nëse u hedh dorën, menjëher' do thyhen!

Menjëher' do thyhen, mesi i hollë i vajzës
shkon përmes të rrethit, rrethit të unazës;
hedhur si lastare, hedhur si bilonja;
zonjat musi çupa, çupat musi zonja;
palët mu si valët, shkon e vjen një tjetër,
duket thanë e kuqe edhe femr' e vjetër!

III

Blegërin një dele, tingëllin një zile,
bota paska halle, hallet me kaçile;
hallet me kaçile, halle prej 'Tirane,
lum Tiranë e kuqe mbushur me zeshkane!

Mir'po — vazhdon Halla, pakëz e çuditur,
rri si rri sorkadhja, çap e vrap lajthitur —
mir' po ra mëngjezi, rrugët do i masin,
erdhi darka vjehrrës buzën i pëlcasin;
lozën edhe karta, birçe ose birç,
çekan e çekiç në 'kokë e godiç.

Folu, nuk të flasin; ktheu, zënë e shkasin
dhe me cep të syrit din' se si të vrasin.

Dhe ajo që duket engjëllushë e butë
në një shishe brenda dy shejtanë futë;
llëra lakuriq, këmba lakuriq,
demek sa për mua... edhe burri vdiq!

IV

Hanko Halla isha, Hanko Halla jam,
hal' në sy i kisha, hal' në sy i kam.
Nuk më mbushet syri, nuk më mbushet zemra,
nuk më piqet ylli me të tilla femra!

Mir'po — vazhdon Halla — edhe psherëtiti, —
aty nga del fjala do më dal' dhe shpirti;
pra do them të drejtën se më bëhet derte,
cilido gjynahun le ta ket' për vete,
kur i pash' të parat, desh më zuri frika,
kur i pash' të dytat... deh, iu rëntë pika!

Ato që mos qofshin, këto për të qenë...
duket pemë e bukur që ka mbir' me hënë:
duket pemë e bukur që me hën' ka mbirë
dhe që asaj dite ish sahat i mirë;
porosita djalin: — Nëse të kam djalë,
ik e i thuaj nuses të ma bëj hallallë! —

Aty Halla heshti, hoqi, psherëtiti,
 një kujtim i vjetër erdhi e goditi...
 Kur ish Hanko Halla nuse topi i borës,
 kur «Ai» e mbante në pëllëmbë të dorës,
 vishej edhe ngjishej sikurse një flutur,
 sikurse një flutur nëpër fleta futur!

Sako dhe tumane... ar edhe mëndafsh,
 varur pendolirat... shko një her', më qafsh...
 shkonte si veri e vinte si tallas,
 këmba, si krah zogu, s'linte gjurma pas!

Halla ish një lule, dhe nga ato lule,
 syri me ta parë, mu në gjunj' u ule.
 Ajo ish një lule, po edhe «Ai»
 ish për atë lule një saksi flori.
 Fundi i fjalës Halla ish një dallëndyshe,
 si ish e si qenka.. jan' dy gjëra ndryshe!

1870
The first of the year
with a very heavy snow
fall on the 1st of the month
and continued to fall
until the 10th of the month
when it cleared away
and the weather became
clear and bright.

The 11th of the month
was a very cold day
with a heavy frost
and the weather was
very disagreeable.

The 12th of the month
was a very cold day
with a heavy frost
and the weather was
very disagreeable.
The 13th of the month
was a very cold day
with a heavy frost
and the weather was
very disagreeable.

The 14th of the month
was a very cold day
with a heavy frost
and the weather was
very disagreeable.
The 15th of the month
was a very cold day
with a heavy frost
and the weather was
very disagreeable.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Parathënje	3
Këngë	7
Gjoni	8
Dëshpërim dhe shpresë	12
Vlora, Vlora	15
Për dëshmorët	17
Pranvera në Shqipëri	19
Okupatorëve.	21
Shakërrim	23
Perlat Rexhepi	27
Botë e re kjo, tungjatjeta!	28
Shkencë e vjershë ranë godi	29
Iman efendiu	32
Nastradini — Mussolini	34
Që kurse u prish dynjaja	36
Kanga e Mukës duhet të heshtë	38
Dallëndyshet dhe vajzat	40
Pyeta valët vogëlushe	41
Katër stina, katër çapa	43
Më lejon ta puth një herë	49
Vajzat heqin valle	51
Hanko Halla — poemë —	53